❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektesh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Specialist Kontratash

❖ DETYRAT KRYESORE

- Pergjigjet per pergatitjen e formateve te standartizuara te kontratave te ndertimit, sipermarrjes, shit-blerjes, bashkepunimit, qirase, punesimit, sherbimit, etj., dhe revizionimin e tyre.
- Ofron rishikim te plote dhe te shpejte te dokumentave te pergatitur nga pale te tjera.
- Kontrollon mirembajtjen e skedareve te detajuar dhe te organizuar per cdo kontrate nga Administratoret e Kontratave.
- Kontrollon, ndryshon, raporton tek strukturat pergjegjese rregjistrin e pergjegjesive kontraktuale midis paleve te ndryshme (Action/Notice/Liability Matrix) dhe kontrollon ekzekutimin e kontratave ne perputhje me kushtet kontrakuale dhe politikat e kompanise.
- Kontrollon pergatitjen e njoftimeve sipas kerkesave kontraktuale; monitoron performancen e Nenkontraktoreve; raporton statusin dhe plotesimin e kushteve kontraktuale te Punedhenesve, Kompanise dhe Nenkontraktoreve, ose Paleve te tjera te Treta.
- Rishikon dhe finalizon korrespondencen e pergatitur nga struktura te ndryshme te kompanise dhe/ose Administratoret e Kontratave ne lidhje me zbatimin e kontratave.
- Kontrollon mbylljet e cdo Kontrate ne fund te periudhes (close Out) dhe leshimin/marrjen e garancive te lidhura me kontratat.

❖ KRITERET KRYESORE

Edukimi: Të ketë përfunduar fakultetin Juridik. Preferohet të ketë kualifikim në nivel pasuniversitar në fushën e juridikut ose financës.
Gjuhë të huaja: Anglisht (shkëlqyer), Italisht (shumë mirë).
Njohuri kompjuterike: Paketa Microsoft Office
Eksperienca e kërkuar: Min. 6 vite eksperiencë pune në perpilim kontratash. Preferohet të ketë eksperiencë pune në një kompani që operon në fushën e ndërtimit si dhe eksperiencë në kontrata FIDIC.

Te gjithe te interesuarit, jane te lutur qe te dergojne CV nepermjet adreses se e-mailit careers@gener2.al ose te plotesojne formularin e aplikimit ne faqen zyrtare www.gener2.al ne seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit eshte **data 12 Prill 2023, ora 17:00.**

* Vetem kandidatet e perzgjedhur do te kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 mbi “Mbrojtjen e të dhënave personale”.